



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të grupit të operatorëve ekonomik “Lindi Markings” Sh.P.K. & “Beni Com” Sh.P.K. të datës 24.02.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 20.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4” me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e grupit të operatorëve ekonomik “Lindi Markings” Sh.P.K. & “Beni Com” Sh.P.K. e datës 24.02.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 20.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4” me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 20.02.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4” me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211.
- III. NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik “Lindi Markings” Sh.P.K. & “Beni Com” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Grupi i operatorëve ekonomik "Lindi Markings" Sh.P.K. & "Beni Com" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 24.02.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës të datës 20.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Lot 4" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 170 211.

Pretendimet e parashtruesit janë si në vijim:

- 1. Pretendimi i parë** - tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar çertifikatën UNE-EN1436 siç është përcaktuar me dosje të tenderit ndërsa në vend të saj ka dorëzuar çertifikatën UNE-EN12899.
- 2. Pretendimi i dytë** - mostrat për sinjalizim vertikal dhe A-testet e materialeve nuk janë dorëzuar si material DG por si material EGP. Po ashtu janë dorëzuar edhe mostra të tjera pa numër të protokollit.
- 3. Pretendimi i tretë** - për materialet e shenjave vertikale, tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar A-testet e kërkuara në gjuhën italiane, e cila nuk është gjuhë zyrtare dhe as gjuhë e lejuar për përdorim në dokumentet e prokurimit sipas LPP.
- 4. Pretendimi i katërt** – tenderuesi i rekomanduar ka prezantuar një kontratë të qirasë për mjetin e punës "Rimorkio me elemente të sinjalizimit (për paralajmërim për punime në rrugë)" sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit. Mirëpo kjo kontratë e prezantuar nga operatorit ekonomik i referohet një aktiviteti tjetër të prokurimit me numër tjetër të prokurimit, dhe jo aktivitetit për të cilin ka ofertuar tenderuesi.
- 5. Pretendimi i pestë** – tenderuesi i rekomanduar nuk i posedon të gjitha pajisjet e kërkuara në kuadër të kapaciteteve teknike dhe profesionale të dosjes së tenderit.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 13, 28, 59, 60, dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 03.03.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet numër një (1), dy (2), katër (4) dhe pesë (5) janë të pabazuara në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nën paragrafi d) të RRPP. Njëkohësisht është gjetur se pretendimi me numër tre (3) i parashtruesit është i bazuar në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

Sa i përket pretendimeve me numër një (1), dy (2), katër (4) dhe pesë (5), pas analizimit të tyre është gjetur se lidhur me këto pretendime parashtruesi nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme. Rrjedhimisht këto pretendime si të tilla janë të pabazuara pasi që nga dosja e tenderit mund të vërtetohet e kundërta e tyre sipas elaborimeve në vijim:

- **Sa i përket pretendimit numër një (1)**, nga dosja e ofertës së tenderuesit të rekomanduar mund të vërtetohet se është dorëzuar siç është kërkuar edhe çertifikata UNE-EN1436. Për këtë arsye ky pretendim është i pabazuar.
- **Sa i përket pretendimit numër dy (2)**, nga dosja e ofertës së tenderuesit të rekomanduar mund të vërtetohet se mostrat për sinjalizim vertikal dhe atestet e materialeve janë dorëzuar si material DG. Njëkohësisht nga dosja e ofertës nuk rezulton që të jenë pranuar mostra në mënyrë të parregullt qoftë të dorëzuara në dy apo më shumë herë apo në forma të tjera. Prandaj ky pretendim është i pabazuar.
- **Sa i përket pretendimit numër katër (4)**, nga dosja e ofertës mund të vërtetohet se kontrata e qirasë të cilës i referohet parashtrues është paraqitur si dokument shtesë dhe jo si dëshmi për kriteret e kërkuara në dosjet e tenderit. Për këtë arsye ky pretendim është i pabazuar.
- **Sa i përket pretendimit numër pesë (5)**, nga raporti i komisionit vlerësues dhe rekomandimi i bërë nga komisioni vlerësues pas daljes së tyre në teren për verifikimin e posedimit të pajisjeve të kërkuara, mund të vërtetohet se tenderuesi i rekomanduar i posedon të gjitha pajisjet e kërkuara në kuadër të kapaciteteve teknike dhe profesionale të dosjes së tenderit. Për këtë arsye ky pretendim është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit numër tre (3) është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente dhe dëshmi të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Rrjedhimisht ky pretendim është i bazuar sipas elaborimeve në vijim:


- **Sa i përket pretendimit numër tre (3)**, fillimisht duhet theksuar se përmes nenit 13 paragrafit 4 të LPP përcaktohet se *“Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze”*. Nga dosja e ofertës së tenderuesit të rekomanduar mund të vërtetohet se A-testet e materialeve të shenjave vertikale (kapacitetet teknike dhe profesionale sipas dosjes së tenderit) janë dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar janë në gjuhën italiane. Kjo është në kundërshtim me dispozitën ligjore të LPP të cituar si më sipër. Përndryshe edhe në njoftimin për kontratë në seksionin e evidentuar si *“V.2) Informacionet shtesë”* është përcaktuar se *operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze”*. Rrjedhimisht ky pretendim i parashtruesit është i bazuar.


Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parashtruesit me numër tre (3) është pretendim i bazuar. Kjo pasi që sipas pretendimit numër tre (3) është gjetur se komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me nenin 13 paragrafin 4 të LPP.

Për pikën I të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. të RRPP. Për pikën II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në 7 të LPP lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.3. pikën a) të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 03.03.2023


Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.